



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

VENDIM

Nr. 688 datë 15.11.2023

MBI

KËRKESËN E GJYQTARES {...} PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 20.05.2021, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “ *Mbi projekt-vendimin mbi kërkesën e gjyqtares {...} për dhënie leje të papaguar*”, përgatitur nga relatorja, znj. Yllka Rupa, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VËREN:

1. FAKTET E ÇËSHTJES

1.1 Më datë 20.10.2023 znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ka paraqitur në rrugë elektronike “Kërkesë për dhënie leje të papaguar për periudhën nga data 20.10.2023 deri në datë 31.03.2024”, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 5493 prot., datë 20.10.2023.

1.2 Në kërkesën me shkrim znj. {...} parashtron se; “Unë {...}, emëruar gjyqtare me Vendimin nr. 558, datë 12.10.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe caktuar në pozicion me Vendimin nr. 598, datë 19.10.2023, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Këshillit të Lartë Gjyqësor për përfitimin e lejes së papaguar për arsye familjare, në kuptim të nenit 24, paragrafi 3 i ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" si dhe Vendimit Nr.72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në datë 26.06.2023 kam sjellë në jetë djalin tim i cili sot në paraqitjen e kësaj kërkesë është 22 javësh (gati 4 muajsh). Arsyeja për të cilën kërkoj përfitimin e lejes së papaguar lidhet me përgjegjësinë time për mirërritjen dhe për kujdesin ndaj fëmijës së mitur. Aktualisht fëmije ushqehet ekskluzivisht me gji dhe kjo kushtëzon praninë time për një periudhë të paktën 9 mujore pranë tij, moshë në të cilën fëmijët jo

vetëm janë përshtatur me të tjera lloje ushqimi por mund të regjistrohet në institucione që mund të kujdesen për të (çerdhe). Gjykata ku unë jam caktuar për ushtrimin e funksionit gjendet në një distancë të konsiderueshme nga vendbanimi im, e për këtë arsye është e pamundur që të ushtroj njëkohësisht funksionin edhe për kujdesjen ndaj fëmijës së mitur. Duke qenë se periudha trevjeçare e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, nuk konsiderohet periudhë punësimi dhe nuk llogaritet si e tillë në momentin e caktimit në pozicion (për efekt të përfitimit të lejes së lindjes sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar), si dhe duke qenë se djali im ka ardhur në jetë përpara caktimit tim në detyrën si gjyqtare, po i drejtohem Këshillit, me këtë kërkesë me objekt për përfitimin e lejes së papaguar për arsye familjare. Duke patur gjithmonë në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, të sanksionuar në Kushtetutën e RSH-së, në Konventën e Kombeve të Bashkuara (OK B) për të drejtat e fëmijëve, si dhe në nenin 2 të Kodit të Familjes, kërkoj miratimin e kësaj kërkesë nga ana juaj. Bashkëlidhur kësaj kërkesë po ju dorëzoj dokumentet që provojnë faktin e përshkruar më lart."

1.3 Për qëllime të vërtetimit të situatës faktike të përshkruar në këtë kërkesë, magjistratja ka paraqitur: *Çertifikatë familjare, Çertifikatë lindje, datë 19.10.2023, raporte për barre lindje.*

2. PROCEDURA E ZHVILLUAR

2.1 Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me pikën VII të Vendimit Nr. 72 dt. 20.05.2019 "Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor", ku u kërkuar mendimi i Zv/Kryetarit të gjykatës si dhe u kërkuar informacion nga kancelarja e gjykatës në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve.

2.2 Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nëpërmjet postës elektronike darë 24.10.2023, ka përcjellë mendim, duke parashtruar se; "*Duke marrë parasysh gjyqtaret aktual Aurel Arapi (Zv.Kryetar) dhe Ilir Përdeda (gjyqtar), ku secili nga gjyqtarët aktualë ka një ngarkesë pune prej afro 500 dosjesh gjyqësore dhe tashmë janë emëruar 6 magjistratë të rinj, konkretisht z.Elvis Sulejmani, z.Renis Sheshi, znj. {...}, z.Aldi Kareco, z.Lirim Bulica dhe znj. Eglantina Biba, me vendimet përkatëse nr.599, 602, 598, 603, 616, 613 të datë 19.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e lë në vlerësimin tuaj kërkesën."*

2.3 Kancelarja e gjykatës nëpërmjet postës elektronike më datë 23.10.2023 paraqiti informacionin e kërkuar në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në lidhje me organikën e gjykatës në të cilën rezultojnë të jenë efektiv 8 gjyqtarë, nga të cilët 6 gjyqtarë të emëruar rishtaz, si dhe ngarkesën aktuale të gjyqtarëve, duke përcaktuar numrin e çështjeve në gjykim për secilin gjyqtarë, z.Aurel Arapi dhe z. Ilir Perdeda, të cilët rezultojnë të kenë në shqyrtim nga rreth 500 çështje secili.

2.4 Pas përfundimit të procedurës si më sipër, brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës së gjyqtarës, në mbledhjen e datës 02.11.2023 Komisioni vendosi që kjo çështje t'i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

2.5 Çështja u mor në shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit më datë 15.11.2023, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të Vendimit nr.72 datë 20.05.2019 të KLGJ.

3. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

3.1 Neni 24 i Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Përveç pushimeve vjetore, magjistrati gëzon të drejtën të marrë në përputhje me Kodin e Punës: a) pushime të tjera; b) leje prindërore... 6. Këshilli përcakton rregulla më të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar.” (neni 24 pika 6 i Ligjit nr. 96/2016).

3.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar vendimin nr.72 datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, në të cilin përcaktohen kriteret dhe procedura e dhënies së këtyre lejeve.

3.3 Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 të Ligjit nr.96/2016 dhe Vendimi nr.72 datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4 parashikojnë tre lloje të lejes, dhe konkretisht :

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. **Leje për arsye familjare** dhe/ose shëndetësore;

3.4 Lidhur me kushtet për dhënien e lejes për arsye familjare dhe/ose shëndetësore, pika 8 e Vendimit nr. 72 datë 20.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, parashikon kushtet si më poshtë:

“Leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet, jepet nga Këshilli si më poshtë:

a) Gjyqtari që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Në rast të nevojave urgjente kërkesa paraqitet menjëherë pa vonesë. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes dhe afatin e lejes së kërkuar. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës;

b) Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit;

c) Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por në total jo më shumë se 2 vjet. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim;

ç) Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.”

4. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

4.1 Nga informacioni i marrë nga dosja personale e gjyqtares, rezulton se znj. {...} është emëruar gjyqtare me vendimin nr. 558 dt. 12.10.2023 të KLGJ, dhe është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë me vendimin nr.598, dt. 19.10.2023. Në datën 20.10.2023 ajo ka bërë betimin para KLGJ-së dhe ka filluar ushtrimin e detyrës. Në po atë datë nga ana e saj është paraqitur kërkesa e parashtruar më lart, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 5493 prot., datë 20.10.2023.

4.2 Gjyqtarja {...}, ka paraqitur kërkesën ditën që ka filluar ushtrimin e detyrës. Referuar arsyes që ajo kërkon këtë leje dhe rrethanave konkrete në të cilat ndodhet, nuk është në rastin kur këtë kërkesë e paraqet 30 ditë para datës kur kërkon të fillojë kjo leje. Sipas kësaj kërkesë, ajo është duke u përkujdesur për fëmijën e saj 22 javësh, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, dhe kërkon që kjo leje t'i jepet menjëherë, pasi çdo ditë që vijon të ushtrojë funksionin e ka shumë të vështirë të realizojë ushqimin dhe përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur pasi gjykata në të cilën ajo është caktuar për të ushtruar funksionin e saj si gjyqtare, ka një distancë të konsiderueshme nga vendbanimi. Kërkesa është paraqitur me shkrim më datë 20.10.2023 dhe leja kërkohet për një periudhë konkretisht deri në datë 31.03.2024, duke filluar menjëherë nga data që jepet kjo leje. Kërkesa është e shoqëruar me certifikatë familjare dhe certifikatë personale e fëmijës së mitur. Leja kërkohet për t'u përkujdesur për një fëmijë të mitur i cili është vetëm 22 javë dhe kjo leje të jepet deri në datë 31.03.2024, moment që i mituri kalon në një fazë tjetër të ushqyerjes edhe në mënyrë suplementare.

4.3 Në kërkesën e znj. {...} parashtrohet se kërkohet leje e papaguar për arsye familjare dhe nga ana e vetë magjistrates bëhet dallimi që në këtë rast, nuk jemi para kërkesës për leje prindërore, edhe pse arsyeja e kësaj leje është pikërisht dhënia e mundësisë për të qëndruar pranë dhe përkujdesur për fëmijën e saj të mitur 22 javësh.

4.4 Për sa më sipër, rezulton se kërkesa e Gjyqtares {...} për leje të papaguar për arsye familjare deri në datë 31.03.2024 duhet miratuar, duke filluar kjo leje menjëherë, pasi përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24 të Ligjit nr. 96/2016 dhe Vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për “Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

4.5 Këshilli vlerëson së në këtë rast, në respektim të parimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Familjes, Legjislacionin e marrëdhënieve të punës dhe atë të sigurimeve shoqërore, leja e papaguar, e kërkuar për këtë arsye, nuk mund të refuzohet.

4.6 Parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës sanksionohet në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të drejtat e fëmijëve në të cilin përcaktohet se: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”*. Në respektim të këtij parimi, Kodi i Familjes parashikon dhe rithekson detyrimin për respektimin e interesit më të lartë të fëmijës në një sërë dispozitash të tij ndër të cilat, neni 2 parashikon se: *“Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”*.

4.7 Në kuadër të garantimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, të sanksionuar në Kushtetutë dhe në instrumentet ndërkombëtarë për të drejtat e fëmijëve, ligjvënësi me qëllim përafrimin e legjislacionit me Direktivat e BE-së, ka ndryshuar Kodin e Punës me ligjin 136/2015, i cili ka hyrë në fuqi në datë 22.06.2016, duke parashikuar:

- Ndalimin e punës për gratë shtatzëna dhe nënat e reja, neni 104. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, qartazi përcaktohet që; gratë shtatzëna, 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë paslindjes, *ju ndalohet të punojnë*. Pas përfundimit të kësaj periudhë, gruaja që sapo ka lindur dhe /ose gruaja me fëmije në gji, **vendos vetë** nëse do të shkojë në pune .
- Lejen e lindjes, neni 105. Sipas referimit në këtë dispozitë, në nenin 27/2 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, parashikohet se ; *Periudha e përfitimit do të jetë 365 ditë kalendarike, duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 42 ditësh pas lindjes së fëmijës..”*. Nga këto parashikime ligjore, konkludohet se **leja e lindjes është deri sa fëmija bëhet 11 muaj**. Gjithashtu, po kjo dispozitë pika 2, parashikon se; *Pas periudhës 63 - ditore të pas lindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore”*.
- Lejen Prindërore, neni 132/1 si të drejtë vetjake (e patransferueshme) të punëmarrësit, që nuk mund t’i refuzohet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi plotëson kushtet e dispozitës dhe që duhet konceptuar si mundësi e prindit për t’iu përkushtuar në kohë fëmijës që rritet.

4.8 Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se; nëna me fëmijë të mitur ka të drejtën absolute, të garantuar nga kushtetuta, konventa dhe ligjet e sipërcituara, të qëndrojë dhe përkujdeset për fëmijën e mitur, derisa ai të bëhet 9 muaj.

Në rastin konkret, për shkak të rrethanave të parashtruara nga vetë magjistratja, ajo nuk plotëson kushtet sipas ligjit për sigurimet shoqërore, *thjesht për të përfitur pagesë* për lejelindje, por kjo situatë nuk mund t'i heqë asaj të drejtën për të qëndruar pranë fëmijës, derisa ai të bëhet 9 muaj.

Këshilli vlerëson të theksojë se, kjo leje nuk mbivendoset apo zëvendësohet me lejen prindërore, pasi është një situatë tërësisht e ndryshme. Leja prindërore, sipas kodit të punës, neni 132/1, kërkon plotësimin e një kushti që të mund të përfitohet, dhe që është ekzistenca e një viti pune të pandërprerë me të njëjtin punëdhënës, dhe merret për aq kohë sa fëmija nuk ka mbushur moshën 6 vjet. Ndërkohë, kur fëmija *nuk është më shumë se 11 muaj*, referuar legjislacionit të sipërcituar, ky kusht nuk ekziston, pasi është një e drejtë absolute e nënës për të kujdesur për fëmijën deri në këtë moshë, dhe nuk lidhet me plotësimin e asnjë kushti.

Në këtë rast, mjafton që nëna ta kërkojë, pasi ligji përcakton shprehimisht se, është vetëm nëna ajo që vendos të punojë apo jo, gjatë kësaj periudhe.

5. KONKLUZIONI

Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtarës {...} për dhënie leje të papaguar, përmbush kushtet ligjore dhe ato të përcaktuara në aktin nënligjor të KLGJ dhe si e tillë duhet të miratohet. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit nr.115/2016, ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61, 68 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, nenit 24 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Vendimin nr. 72 datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, bazuar në kërkesën e znj. {...} më datë 20.10.2023.

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së Znj. {...}, Gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për dhënie leje të papaguar për arsye familjare deri me datën 31.03.2024.
2. Njoftimin e këtij vendimi Gjyqtarës {...}, dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrativë të Apelit brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga e nesërmbja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR